REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 29 tetor 2021
Nr.ref.:RK 1879/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI23/19

Parashtrues

Agim Hoxha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,
CML. nr. 45/2018, të 20 dhjetorit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Agim Hoxha nga Gjakova (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), përfaqësuar nga Ylli Xhiha, avokat nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës Supreme [CML.nr.45/2018], të 20 dhjetorit 2018, në lidhje me Konkluzionin e Përmbaruesit Privat [P.nr.611/18] të 10 tetorit 2018; Konkluzionin e Gjykatës Themelore në Gjakovë [E.nr.2302/9], të 22 majit 2018; Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac.nr.3166/2015], të 31 marsit 2017; Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë [E.nr.2302/2009] të 25 nëntorit 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara me të cilat pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

4. Parashtruesi i kërkesës po ashtu ka kërkuar caktimin e masës së përkohshme me qëllim të mbrojtjes së paluajtshmërisë së tij dhe shmangies së dëmit të pariparueshëm.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113 (7) [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 4 shkurt 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

7. Më 8 shkurt 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.

8. Më 26 shkurt 2019, parashtruesi i kërkesës u njoftua për regjistrim të kërkesës dhe një kopje e kërkesës iu dërgua Gjykatës Supreme.

9. Më 14 gusht 2019, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore që ta dorëzon dosjen e plotë lidhur me kërkesën nr. KI23/19.

10. Më 28 gusht 2019, Përmbaruesi Privat Gjokë Radi përmes Gjykatës Themelore në Gjakovë, njoftoi Gjykatën se dosja e plotë për kërkesën nr. KI23/19 është përcjellë tek Gjykata e Apelit.

11. Më 2 shtator 2019, Gjykata kërkoi nga Gjykata e Apelit që ta dorëzon dosjen e plotë lidhur me kërkesën nr. KI23/19.

12. Më 12 shtator 2019, Gjykata e Apelit njoftoi Gjykatën se lënda që ndërlidhet me kërkesën nr. KI23/19, është e përfunduar dhe se dosja e plotë duhet të kërkohet nga Gjykata Themelore në Gjakovë.

13. Më 26 shtator 2019, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzon dokumente shtesë: 1) Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit [KMLC.nr.147/2018], të 23 tetor 2018; 2)Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac.nr.3166/2015], të 31 marsit 2017; 3) Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë [Ekz.nr.2023/09] të 14 dhjetorit 2009; 4) Konkluzionin e Gjykatës Themelore në Gjakovë [E.nr.2302/9], të 22 majit 2018; 5) Konkluzionin e Përmbaruesit Privat [P.nr.611/18] të 10 tetorit 2018.

14. Më 14 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumentet e lartpërmendura në Gjykatë.

15. Më 6 janar 2020, parashtruesi i kërkesës kërkoi caktimin e masës së përkohshme me qëllim të shmangies së dëmit të pariparueshëm dhe për mbrojtje të paluajtshmërisë së tij deri në vendosje meritore të kërkesës nr. KI23/19.

16. Më 6 shkurt 2020, Gjykata sërish kërkoi nga Gjykata e Apelit që të dorëzojë dosjen e plotë lidhur me kërkesën nr. KI23/19.

17. Më 7 shkurt 2020, Gjykata e Apelit përsëriti se lënda që ndërlidhet me kërkesën nr. KI23/19 është lëndë e përfunduar dhe se dosja e plotë duhet të kërkohet nga Gjykata Themelore në Gjakovë.

18. Më 2 shtator 2020, Gjykata sërish kërkoi nga Përmbaruesi Privat Gjokë Radi që ta dorëzon dosjen e plotë lidhur me kërkesën nr. KI23/19.

19. Më 14 shtator 2020, Përmbaruesi Privat Gjokë Radi dorëzoi në Gjykatë dosjen e plotë lidhur me kërkesën nr. KI23/19.

20. Më 25 nëntor 2020, Gjykata shqyrtoi rastin dhe vendosi që vendimmarrjen ta shtyjë për një seancë tjetër në përputhje me plotësimet e kërkuara.

21. Më 9 shkurt 2021, Gjykata njoftoi Ministrinë e Drejtësisë, Odën e Përmbaruesve Privat dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës lidhur me kërkesën KI23/19, me ç 'rast kërkoi sqarime nga institucionet në fjalë përkitazi me disa aspekte të punës së përmbaruesve privatë në territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë.

22. Më 11 shkurt 2021, Këshilli Gjyqësor i Kosovës njoftoi Gjykatën se të gjitha informatat për punën e përmbaruesve privatë mund të merren te Ministria e Drejtësisë.

23. Më 15 shkurt 2021, Oda e Përmbaruesve Privat dorëzoi opinion për punën e përmbaruesve privatë si dhe disa dokumente tjera siç janë: (i) Procesverbal P.nr.611/18, i 4 marsit 2019; (ii) Deklaratë të përmbaruesit privat Gjokë Radi,

P.nr.611/18, të 4 marsit 2019; dhe (iii) Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë PPP.nr.74/19, të 12 marsit 2019.

24. Më 3 mars 2021, Ministria e Drejtësisë, mes tjerash, njoftoi Gjykatën për numrin e përmbaruesve privat në territorin e Gjykatës Themelore të Gjakovës.

25. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

26. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.

27. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit KSH23/19, emëroi Gjyqtarin Bajram Ljatifi si anëtar të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu.

28. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani morri detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.

29. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës Gresa Caka-Nimani, nxori Vendimin K.SH.KI23/19, duke e zëvendësuar Kryetaren paraprake Arta Rama-Hajrizi në rolin e saj si kryesuese në këtë Kolegj shqyrtues.

30. Më 1 korrik 2021, Gjykata shqyrtoi rastin dhe vendosi që vendimmarrjen ta shtyjë për një seancë tjetër në përputhje me plotësimet e kërkuara.

31. Më 7 korrik 2021, një kopje e kërkesës iu dërgua Raiffeisen Bank sh.a., dega në Gjakovë me mundësi për të dorëzuar komentet e tyre, nëse kanë, në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e pranimit të kopjes së kërkesës KI23/19.

32. Më 23 korrik 2021, Raiffeisen Bank J.S.C Kosovë dorëzoi përgjigje ndaj kërkesës nr. KI23/19 duke theksuar se Gjykata Supreme nuk ka shqyrtuar fare kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë sepse është paraqitur jashtë afatit sipas dispozitave të LPK-së.

33. Më 7 tetor 2021, Kolegji Shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

34. Zanafilla e këtij rasti ndërlidhet me marrëveshjen për hipotekë të lidhur ndërmjet parashtruesit të kërkesës në cilësi të debitorit-kredi marrës dhe Raiffeisen Bank-Kosovë (në tekstin e mëtejmë, RBKO) në cilësi të kreditorit.

Procedurat gjyqësore pranë gjykatave të rregullta

35. Nga shkresat e përfshira në kërkesë, rezulton se më 18 nëntor 2009, kreditori RBKO, kishte paraqitur propozim për përmbarim, në Gjykatën Komunale në Gjakovë, për shitje të paluajtshmërisë së parashtruesit të kërkesës (dhe debitorëve të tjerë) me qëllim të realizimit të kredisë ndaj parashtruesit të kërkesës (debitorit).

36. Më 14 dhjetor 2009, Gjykata Komunale në Gjakovë me Aktvendimin [Ekz.nr.2302/09] ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues marrëveshjes së hipotekës. (Sqarim: ky vendim është marrë nga gjyqtari individual A.M.).

37. Më 22 shkurt 2013, Gjykata Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Gjokë Radi duke vendosur sipas propozimit të autorizuarit të kreditorit RBKO vendos për caktimin e shitjes publike të paluajtshmërive të evidentuara në emër të Agim Hoxhës (parashtruesin e kërkesës dhe debitorëve tjerë). Me Konkluzion [E.nr.2302/09] u vendos që shitja publike të mbahet më 25 mars2013.

38. Parashtruesi i kërkesës (dhe debitorët tjerë) përmes parashtresës së datës 7 mars2013 kishte kundërshtuar Konkluzionin [Ekz.nr.2302/09] e datës 22 shkurt2013.

39. Më 25 mars 2013, Gjykata Themelore në Gjakovë kishte marrë Konkluzion [Ekz.nr.2302/09] mbi shitjen e dytë publike të paluajtshmërive. Gjykata Themelore kishte theksuar se ndaj këtij Konkluzioni nuk lejohet ankim i veçantë.

40. Më 18 korrik 2013, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur prapësim përmes postës (regjistruar më 22 korrik 2013) kundër Aktvendimit të Gjykatës Komunale në Gjakovë [E.nr.2302/09] të 14 dhjetorit 2009. Nga shkresat e lëndës vërehet se dhe debitorët e tjerë në data të caktuara kishin paraqitur prapësim.

41. Më 14 gusht 2013, kreditori RBKO paraqiti pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë përgjigje në prapësim të parashtruesit të kërkesës (debitorit) duke kërkuar që të refuzohet në tërësi i pabazuar prapësimi dhe Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë [E.nr.2302/09] të 14.12.2009 të mbetet në fuqi.

42. Më 25 nëntor 2013, Gjykata Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejmë, Gjykata Themelore) me Aktvendimin [E.nr. 2302/09] kishte refuzuar prapësimin e parashtruesit të kërkesës. Gjykata Themelore në mënyrë të përmbledhur kishte shpjeguar: *"Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit dhe gjeti se përmbarimi është lejuar në bazë të dokumentit përmbarimor, si marrëveshje mbi lejimin e kredisë, marrëveshje mbi regjistrimin e hipotekës*

dhe shkresa tjera në lëndë. Andaj pretendimet e debitorit nga prapësimi, nuk hyjnë në shkaqet e parapara ligjore për ushtrimin e prapësimit nga neni 55 i LPP-së dhe nuk mund të trajtohen si shkaqe që mund të pengojnë përmbarimin e lejuar nga Gjykata." Trupi Gjykues i Gjykatës Themelore ishte përbërë nga gjyqtari individual Gjokë Radi.

43. Më 27 nëntor 2013, Gjokë Radi me Vendim të Ministrit të Drejtësisë së Republikës së Kosovës [nr.286/2013] i 27 nëntorit 2013 ishte emëruar Përmbarues Privat për territorin e Gjykatës Themelore në Gjakovë.

44. Më 16 janar 2014, parashtruesi i kërkesës përmes përfaqësuesit të tij paraqiti ankesë kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë [E.nr.2302/09] i 25 nëntorit 2013 në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

45. Më 11 gusht 2015, Kreditori RBKO kishte paraqitur përgjigje në prapësim duke propozuar që ankesa e parashtruesit të kërkesës të refuzohet në tërësi e pabazuar dhe që Aktvendimi i Gjykatës Themelore [E.nr.2302/09] i 14 dhjetorit 2009, për lejimin e propozimit për përmbarim, të mbetet në fuqi.

46. Më 31 mars 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.3166/2015] e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore [E.nr.2302/09] të 25 nëntorit 2013. Gjykata e Apelit vlerësoi: (i) se Aktvendimi i goditur është i drejtë dhe i ligjshëm sepse nuk karakterizohet me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) se marrëveshja mbi hipotekën e lidhur ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe kreditorit RBKO është dokument përmbarues i parashikuar me ligjin për procedurën përmbarimore; dhe se, (iii) parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar se dokumenti përmbarues është pa efekt juridik.

47. Në këtë Aktvendim nuk kishte këshillë juridike nëse parashtruesi i kërkesës mund të ankohej në shkallë më të lartë gjyqësore.

Procedurat e zhvilluara para Përmbaruesit Privat, Gjokë Radi

48. Më 21 maj 2018, kreditori RBKO i ishte drejtuar Gjykatës Themelore me kërkesë që "lënda përmbarimore" t'i transferohet Përmbaruesit Privat Gjokë Radi, me seli në Gjakovë.

49. Më 22 maj 2018, Gjykata Themelore me Konkluzionin [E.nr.2302/9] lejoi transferimin e lëndës përmbarimore tek Përmbaruesi Privat Gjokë Radi. Gjykata Themelore vlerësoi se kërkesa e kreditorit RBKO është e bazuar në ligjin për procedurën përmbarimore dhe shpjegoi se *"në pajtim me ligjin në fjalë të gjitha "lëndët përmbarimore" të parashtruara para 1 janarit 2014 do të mbeten në juridiksion të gjykatave themelore, përveç nëse propozuesi-kreditori kërkon transferim tek Përmbaruesi Privat"*. Gjykata Themelore në këshillë juridike kishte përcaktuar shprehimisht se kundër konkluzionit të lartpërmendur nuk lejohet ankesa.

50. Më 19 qershor 2018, Përmbaruesi Privat Gjokë Radi nxori Konkluzion [P.nr.611/18], për vazhdimin e lëndës përmbarimore.

51. Më 10 tetor 2018, Përmbaruesi Privat Gjokë Radi nxori Konkluzion [P.nr.611/18] për shitjen e parë të paluajtshmërive në ankand publik bazuar në dispozitat përkatëse të ligjit për procedurë përmbarimore. Konkluzioni parashikonte shitjen e ngastrës kadastrale nr. 1419-0 Gjakovë-Qytet, me sipërfaqe të përgjithshme prej 358 m² e vlerësuar në shumën prej 29.500,00 euro në pronësi të parashtruesit të kërkesës dhe vëllait të tij A.H., dhe banesën në Gjakovë, apartamenti nr. 1587, në sipërfaqe prej 74 m² e vlerësuar në shumën prej 11, 100.00 euro, në pronësi të parashtruesit të kërkesës. Përmbaruesi Privat Gjokë Radi në udhëzimin juridik kishte përcaktuar shprehimisht se kundër konkluzionit të lartpërmendur nuk lejohet ankesa.

52. Parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit me propozim që të paraqet kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Konkluzionit të Përmbaruesit Privat Gjokë Radi [P.nr.611/18] të 10 tetorit 2018, dhe Konkluzionit të Gjykatës Themelore [E.nr.2302/2009] të 22 majit 2018. Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, parashtruesi i kërkesës, mes tjerash, kishte pretenduar: "*Është konflikt interesi Konkluzion i datës 22.05.2018 ashtu që përmbaruesi i njëjtë i cili nga shkresat e lëndës ishte Gjyqtar në Aktvendimet përcjellëse të zhvilloj procedurën si organ përmbarues.*"

53. Më 23 tetor 2018, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë [KMLC.nr.147/2018] në Gjykatën Supreme kundër Konkluzionit të Përmbaruesit Privat Gjokë Radi [P.nr.611/18], të 10 tetorit 2018 dhe Konkluzionit të Gjykatës Themelore [E.nr.2302/2009], të 22 majit 2018.

54. Më 20 dhjetor 2018, Gjykata Supreme me Aktvendim [CML.nr.45/2018] e refuzoi të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit [KMLC.nr.147/2018] të 23 tetorit 2018, të paraqitur kundër Konkluzionit të Përmbaruesit Privat Gjokë Radi [P.nr.611/18] të 10 tetorit 2018 dhe Konkluzionit të Gjykatës Themelore [E.nr.2302/2009] të 22 majit 2018. Gjykata Supreme, mes tjerash, arsyetoi: (i) me dispozitën e nenit 245.1 të LPK-së parashihet se Prokurori Publik mund të ngre kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë brenda 3 muajsh kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë (ii) se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me Aktvendim me të cilin lejohet përmbarimi apo Aktvendim me të cilin është vendosur për prapësim, por në pyetje janë Konkluzione kundër të cilëve nuk lejohen kurrfarë mjete të goditjes pasi që me to zbatohen disa veprime dhe drejtohet procedura përmbarimore siç parashihet me nenin 3 pika 5 të ligjit për procedurë përmbarimore; (iii) kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë sa i përket Konkluzionit të Gjykatës Themelore është edhe e paafatshme sepse është paraqitur pas afatit 3 mujor të paraparë me dispozitën e nenit 245.1 të ligjit të procedurës kontestimore; dhe (iv) se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë bazuar në nenin 247 të LPK-së mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së kompetencës territoriale, nëse gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë vendim pa seancë kryesore, apo në rast se në kundërshtim me ligjin është përjashtuar publiku pa seancë kryesore.

55. Me këtë rast, Gjykata Supreme kishte theksuar se *"pretendimet e paraqitura në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë nga prokurori i Shtetit paraqiten të pabazuara. Pretendimi i prokurorit të shtetit se gjykata e shkallës se parë gabimisht ka aplikuar dispozitat e nenit 325 par 1 të LPP-së lidhur me nenin 67 par 1 pika (d) të LPK-së është irrelevant dhe pa ndikim pasi që në pyetje është procedura përmbarimore qëllimi i së cilës është që me anë të dhunës të realizohet kërkesa e kreditorit ose të sigurohet përmbarimi i asaj kërkese e nëpërmes organit përmbarues, gjykatës apo përmbaruesit privat."*

Procedurat e zhvilluara për përjashtimin e Përmbaruesit Privat Gjokë Radi, pas dorëzimit të kërkesës KI23/19 në Gjykatë

56. Veprimet procedurale në paragrafët e mëposhtëm 56-61 janë reflektuar pasi që Gjykata ka pranuar dosjen e plotë të lëndës dhe përgjigjet nga Oda e Përmbaruesve Privatë të Kosovës.

57. Më 5 shkurt 2019, (sqarim: një ditë pas dorëzimit të kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese) parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë në Gjykatën Themelore në Gjakovë, për përjashtim të Përmbaruesit Privat Gjokë Radi, në çështjen përmbarimore [P.nr.611/18] të kreditorit RBKO me seli në Prishtinë. Parashtruesi i kërkesës kishte theksuar se Përmbaruesi Privat Gjokë Radi, kishte nxjerrë vendime si gjyqtar e pastaj në të njëjtën lëndë ka vepruar si organ i përmbarimit çka me praktikën gjyqësore nuk lejohet dhe se Gjykata Themelore në Gjakovë duhet ta aprovoj kërkesën duke "abroguar" të gjitha veprimet përmbaruese nga Përmbaruesi Privat Gjokë Radi dhe më pas lënda të "delegohet" te përmbaruesi tjetër.

58. Më 4 mars 2019, Përmbaruesi Privat Gjokë Radi, me Konkluzion [P. Nr. 611/18] vendosi: (i) procedura lidhur me këtë lëndë ndërpritet për shkak të kërkesës së debitorit Agim Hoxha (parashtruesi i kërkesës) për përjashtimin e Përmbaruesit Gjokë Radi nga procedimi lidhur me këtë lëndë; (ii) procedura do të vazhdohet apo lënda do të përcjellët sipas kërkesës së kreditorit (RBKO), pas vendosjes nga Gjykata Themelore në Gjakovë lidhur me kërkesën për përjashtim.

59. Në të njëjtën datë, Përmbaruesi Privat Gjokë Radi kishte dorëzuar Deklaratë [P. Nr. 611/18] në Gjykatën Themelore në Gjakovë, me ç 'rast, mes tjerash, kishte deklaruar se pretendimi i debitorit (parashtruesit të kërkesës) për konflikt interesi nuk ekziston dhe kishte propozuar që e njëjta të hidhet poshtë e pabazuar në pajtim me dispozitat ligjore të LPK-së që ndërlidhen me nenet 17 dhe 325 të LPP-së.

60. Më 12 mars 2019, Gjykata Themelore në Gjakovë me Aktvendim [PPP.nr.74/19] e refuzoi të pabazuar kërkesën e debitorit Agim Hoxha (parashtruesi i kërkesës), për përjashtimin e Përmbaruesit Privat Gjokë Radi, që të procedoi në lëndën [P.nr.611/18]. Gjykata Themelore në pjesën relevante të Aktvendimit kishte arsyetuar: *"Pretendimi nga kërkesa e debitorit [parashtruesi i kërkesës] se është konflikt interesi Konkluzioni i datës 22.05.2018 ashtu që përmbaruesi i njëjtë i cili nga shkresat e lëndës ishte gjyqtar në Aktvendimet përcjellëse të zhvilloj procedurën si organ përmbarues, gjykata e vlerësoi si të pabazuar, pasi që kërkesa e debitorit nuk përbën asnjë nga shkaqet e cekura të nenit 67 të LPK-së, i cili në kuptim të nenit 17 dhe 325 par.2 të LPP, aplikohet*

përshtatshmërish (mutatis mutandis) edhe për përmbaruesin privat, pasi që në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me Aktvendim me të cilin lejohet përmbarimi apo me Aktvendim me të cilin është vendosur për prapësim, por në pyetje është Konkluzioni kundër të cilit sipas nenit 3 par. 6 të Ligjit Nr.05/L-118 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr.04/L-139 për procedurën përmbarimore "nuk është i lejuar mjeti juridik", pasi që sipas nenit 3 par.5 të LPP-së "Konkluzioni nxirret për zbatimin e disa veprimeve dhe për drejtimin e procedurës".

61. Gjykata Themelore në Gjakovë po ashtu kishte përcaktuar se kundër Aktvendimit të lartpërmendur nuk lejohet ankesa.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

62. Gjykata sërish vë në pah pretendimet e parashtruesit te kërkesës se me vendimet: Aktvendimi i Gjykatës Supreme [CML.nr.45/2018] të 20 dhjetorit 2018 në lidhje me Konkluzionin e Gjykatës Themelore në Gjakovë [E.nr.2302/9] të 22 majit 2018; Konkluzionin e Përmbaruesit Privat [P.nr.611/18] të 10 tetorit 2018; Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac.nr.3166/2015] të 31 marsit 2017; Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë [E.nr.2302/2009] të 25 nëntorit 2013, atij i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 (1) të KEDNJ-së.

63. Parashtruesi i kërkesës, mes tjerash, pretendon: (i) prokurori i shtetit mund të paraqes kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë edhe pas afatit 3 mujor sepse kështu përcakton qëndrimi parimor i Gjykatës Supreme; (ii) të caktohet ekspertiza financiare për caktim të shumës reale të borxhit në pajtim me LPP-në dhe rregullat e BQK-së sepse borxhi aktual përfshin edhe penalitetin; (iii) kontrata mbi hipotekën nuk është legalizuar në gjykatë dhe as nuk është noterizuar kurse organi përmbarues po e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues; (iv) "dokumenti i besueshëm" mbi të cilin bazohet shitja e pronës së tij është i kundërligjshëm sepse nuk është vërtetuar nga gjykatat dhe as nuk është noterizuar dhe, (v) Përmbaruesi Privat Gjokë Radi është në konflikt interesi sepse të njëjtën çështje e ka gjykuar si gjyqtar.

64. Lidhur me (i) Qëndrimin Parimor të Gjykatës Supreme, parashtruesi i kërkesës shton: "*Gjykata Supreme ka refuzuar kërkesën me arsyetimin se nuk është paraqitur brenda afatit 3 mujor, mirëpo sipas Qëndrimit Parimor meqenëse Prokurori nuk është person fizik dhe se më gjerësisht sipas këtij qëndrimi mund të paraqitet në çdo kohë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë*".

65. Lidhur me (ii) penalitetin, Parashtruesi i kërkesës pretendon: "*Është jashtëligjore sesi shuma e borxhit të prezantuar në Propozim, nga një kalkulim nga ai edhe me jo profesionistë kishte për të demonstruar një shumë tjetër, duke ditur se penaliteti në aspektin formalo-ligjor kreditori obligohet të mos i kalkuloj, rregull ky i dalë edhe nga Banka Qendrore dhe LPP, me çka ekspertimi financiar kish me qenë hap i duhur për të pasqyruar një borxh të qëndrueshëm pasi në borxhin e prezantuar është kalkuluar dhe penaliteti*".

66. Lidhur me pretendimin se (iii) "dokumenti i besueshëm" mbi të cilin bazohet shitja e pronës së tij parashtruesi thekson se *" është i kundërligjshëm sepse nuk është vërtetuar nga gjykatat dhe as nuk është noterizuar...dhe se mungojnë informatat që kërkohen në dokumentet e noterizuara sikur në nenin 33 të ligjit për noterinë."*

67. Parashtruesi i kërkesës pretendon gjithashtu se (iv): *"Procesi ka devijuar në kundërshtim me Ligjin andaj neni 6 i Konventës Evropiane garanton "E drejta për një proces të rregullt". Si mundet të ketë proces të rregullt kur ka konflikt interesi dhe shkelje tjera të pakontestueshme pas administrimit të provave".*

68. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës pretendon se: *"neni 1023 i ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore: "shkarkimi i dorëzanit për shkak të vonesës së kreditorit: 1. Dorëzani shkarkohet nga përgjegjësia në qoftë se kreditori, me thirrjen e tij pas rrjedhjes për pagesë të kërkesës, nuk kërkon përmbushjen nga debitori kryesor brenda një (1) muaji nga data e kësaj thirrjeje, me çka vlerësojmë se debitori përkatësisht garantuesit kanë përmbushur një kriter të tillë, e një gjë të tillë thuhet edhe nga Komentari i ligjit për Marrëdhënie Detyrimore fq. 745 (pasi afati i parashkrimit të detyrimeve të dorëzanit është kryesisht më i shkurtër se parashkrimi i detyrimeve të detyrimit kryesor)".*

69. Parashtruesi i kërkesës thekson se duhet të anulohen vendimet e gjykatave të të gjitha instancave si dhe të abrogohen të gjitha veprimet "kundër ligjore" të ndërmarra nga organi përmbarues: *"Të anulohet vendimi i Gjykatës Supreme, Apelit dhe Themelore duke i abroguar të gjitha veprimet kundër ligjore të ndërmarra nga organi përmbarues".*

70. Parashtruesi i kërkesës pretendon: *"Kredia në fjalë përmban kontrata të kredisë të pengut e që janë bazë apo kryesore për disbursimin e kredisë, të palegalizuar atë kohë në Gjykatë, ose edhe tani tek Noteri, veprime të pambështetura ligjore bazuar në nenin 21 të Ligjit të procedurës përmbarimore aktual apo 24 të Ligjit të mëparshëm të procedurës përmbarimore për më shumë Titull Ekzekutiv [...] e që bazat juridike për caktimin e përmbarimit Gjykata atëherë e tash Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër, si dhe nenit 22 Dokumenti përmbarues 1.3. dokumenti noterial i pambarueshëm në pajtim me ligjin për noterinë; ashtu që nga shikimi i shkresave të lëndë shifet se kontratat nuk janë të legalizuar në Gjykatë por as të noterizuar."*

71. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Konkluzioni i Gjykatës Themelore në Gjakovë [E.nr.2302/09] i 22 majit 2018 përbën konflikt interesi sepse përmbaruesi privat Gjokë Radi ka qenë gjyqtar dhe ka zhvilluar procedurën si organ përmbarues në kundërshtim me nenet 6 dhe 9. 1.9 të Ligjit Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

72. Në lidhje me vendimet e kontestuara: Aktvendimi i Gjykatës Supreme [CML.nr.45/2018] të 20 dhjetorit 2018 në lidhje me Konkluzionin e Gjykatës Themelore në Gjakovë [E.nr.2302/9] të 22 majit 2018; Konkluzionin e Përmbaruesit Privat [P.nr.611/18] të 10 tetorit 2018; Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [Ac.nr.3166/2015] të 31 marsit 2017; Aktvendimin e Gjykatës Themelore

në Gjakovë [E.nr.2302/2009] të 25 nëntorit 2013, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata (i) të hedhet poshtë propozimi për përmbarim si i kundërligjshëm; (ii) të caktohet ekspertiza financiare për "eliminim" të dyshimeve për penalitetin; dhe (iii) vendimi i Gjykatës t'i kumtohet parashtruesit të kërkesës dhe institucioneve relevante.

Dispozitat relevante ligjore

LIGJI NR. 04/L-139 PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE

KREU VI
PROCEDURA E KUNDËRPËRMBARIMIT

Neni 17
Zbatimi i dispozitave të ligjeve tjera

Në procedurën përmbarimore përshtatshmërish zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër.

Neni 54
Shkaqet për kundër përmbarim

1. Debitori ka të drejtë që në të njëjtën procedurë përmbarimore edhe pasi të ketë përfunduar përmbarimi, të kërkojë nga Gjykata nxjerrjen e Aktvendimit me të cilin i urdhërohet kreditorit që t'ia kthejë atë që e ka marrë në bazë të procedurës së përmbarimit, në qoftë se:

1.1. dokumenti përmbarues me anë të vendimit të formës së prerë është prishur, ndryshuar, anuluar, shfuqizuar, ose në ndonjë mënyrë tjetër është konstatuar se është i pa efekt juridik;

1.2. Aktvendimi apo urdhri për përmbarim me anë të vendimit të formës së prerë është
anuluar apo ndryshuar;

1.3. gjatë kryerjes së procedurave përmbaruese, kreditori ka marrë më shumë sesa vlera e kredisë, përfshirë kostot e përmbarimit dhe kamatat;

1.4. përmbarimi i kryer në një objekt specifik të përmbarimit është i palejuar.

2. Në qoftë se kreditori me anë të përmbarimit e ka realizuar një shumë të hollash, debitori në propozimin për kundër përmbarim mund të kërkojë pagimin e kamatëvonesës që nga dita e pagimit të shumës së tillë.

3. Propozimi për kundër përmbarim nga paragrafi 1. i këtij neni mund të paraqitet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita në të cilën debitori ka marrë dijeni për shkakun e kundër përmbarimit por jo më vonë se një (1) vit nga dita e përfundimit të procedurës përmbarimore.

4. Pas skadimit të afatit nga paragrafi 3. i këtij neni, debitori nuk mund të fillojë kundër përmbarimin, por duhet të fillojë procedurën kontestimore për kërkesën e tij.

Neni 55
Procedura sipas propozimit për kundër përmbarim

1. Propozimin për kundër përmbarim Gjykata ia dërgon kreditorit dhe kërkon nga ai që brenda afatit prej tre (3) ditësh nga dita e dorëzimit të deklarohet lidhur me propozimin e tillë.

2. Nëse procedura e përmbarimit kryhet para përmbaruesit privat, Përmbaruesi Privat, pa vonesë dërgon një kopje të dosjes te Gjykata kompetente dhe njofton palët se procedura sa i përket propozimit për kundër përmbarim vazhdon para Gjykatës kompetente.

3. Po qe se brenda afatit nga paragrafi 1. i këtij neni, kreditori e kundërshton propozimin për kundër përmbarim, atëherë Gjykata për të vendosë pas mbajtjes së seancës gjyqësore.

4. Me Aktvendimin me të cilin miratohet propozimi për kundër përmbarim Gjykata e urdhëron kreditorin që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh t'ia kthejë debitorit, respektivisht personit të tretë atë që e ka marrë me anë të përmbarimit.

5. Aktvendim të këtillë Gjykata nxjerrë edhe po qe se kreditori i përmbarimit nuk deklarohet fare brenda afatit të caktuar, ose kur deklaron se nuk e kundërshton propozimin për kundër përmbarim.

Neni 56
Aktvendimi për kundër përmbarimin

1. Në bazë të Aktvendimit të formës së prerë me të cilin aprovohet propozimi për kundër përmbarim, Gjykata sipas propozimit të debitorit do të caktojë me Aktvendim të posaçëm mjetet dhe objektet për zbatimin e kundër përmbarimit.

2. Në procedurën e mëtejme të kundër përmbarimit në mënyrë të përshtatur do të zbatohen dispozitat e këtij ligji sipas të cilave kryhet përmbarimi.

Neni 323
Statusi dhe kompetencat e përmbaruesit privat

1. Përmbaruesi Privat për kryerjen e autorizimeve publike të besuara me këtë ligj emërohet nga Ministri i Drejtësisë (më tutje: Ministri) për territorin e Gjykatës themelore.

2. Përmbaruesi Privat është kompetent të ndërmarrë të gjitha veprimet të përcaktuara në nenin 341 të këtij ligji dhe veprime të tjera të lejuara apo

përcaktuara për përmbaruesin privat sipas këtij ligji, përveç kur shprehimisht ndalohen me këtë ligj.

3. Përmbaruesi Privat do të ndërmerr veprime për të zbatuar përmbarimin brenda territorit për të cilin është emëruar.

4. Me kërkesë të kreditorit, Përmbaruesi Privat mund të ndërmarr veprime për zbatimin e përmbarimit edhe jashtë territorit për të cilin ai është emëruar, personalisht apo nëpërmes përmbaruesit privat të territorit tjetër.

5. Organet e administratës shtetërore mundet t'i besojnë përmbaruesit privat zbatimin e përmbarimit në procedurat të cilat aplikohen në bazë të vendimeve të këtyre organeve shtetërore, vetëm nëse parashihet ndryshe me ndonjë ligj të veçant.

6. Selia e përmbaruesit privat do të jetë e vendosur brenda territorit të Gjykatës themelore për të cilin ai është emëruar.

Neni 325
Përjashtimi

1. Dispozitat e ligjit të procedurës kontestimore për përjashtimin e gjyqtarëve vlejnë përshtatshmërish edhe për përjashtimin e përmbaruesve privat.

2. Gjyqtari i Gjykatës themelore brenda territorit të cilit është emëruar Përmbaruesi Privat, vendos për kërkesën për përjashtim.

3. Nuk do të lejohet asnjë ankesë kundër Aktvendimit i cili aprovon apo hedh poshtë një kërkesë për diskualifikimin e një zyrtari privat të përmbarimit.

4. Veprimet përmbarimore të përmbaruesit privat të kryera në kundërshtim me paragrafin 1. të këtij neni do të abrogohen.

Neni 327
Caktimi i numrit të përmbaruesve privat

1. Numrin e përmbaruesve privat e cakton Ministri në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Për territorin e Gjykatës themelore një pozitë e përmbaruesit privat, sipas rregullit, caktohet në njëzet e pesë mijë (25.000) banorë.

3. Numri i përmbaruesve privat për territorin e Gjykatës themelore, mund të rritet derisa numri i përmbaruesve privat të emëruar në secilin rajon të arrijë proporcionin e paraparë në paragrafin 2. të këtij neni.

4. Përjashtimisht nga paragrafi 2. i këtij neni, Ministri varësisht nga nevoja apo sipas kërkesës të Këshillit Gjyqësor të Kosovës ose Odës së përmbaruesve cakton edhe numër më të madh të përmbaruesve privat.

Neni 340
Obligimet për përmbarim

1. Përmbaruesi Privat ka detyrim që të kryej obligimet zyrtare për të cilat është i autorizuar në territorin e Gjykatës themelore për të cilin është emëruar përveç në qoftë se:
1.1 .ekzistojnë arsyet për përjashtim;
1.2. propozuesi përmbarimor nuk paguan avansin për kryerjen e detyrave zyrtare siç kërkohet nga Përmbaruesi Privat në bazë të këtij ligji.

2. Nëse lindin rrethana siç janë të përshkruara në paragrafin 1. të këtij neni, Përmbaruesi Privat, përderisa kjo bie në kompetencat e tij, ndërmerr masat e nevojshme për të siguruar që veprimet përmbarimore mund të kryhen në nivel lokal nëse kjo kërkohet. Për këtë, Përmbaruesi Privat mund të kërkojë nga Ministri që të emërojë zëvendësuesin e përmbaruesit privat. Ai mund të rekomandojë zëvendësuesin e përmbaruesit privat.

3. Nëse Përmbaruesi Privat ka qenë i penguar të kryej detyrat sipas mandatit të tij për më shumë se tridhjetë (30) ditë, ai do të informojë për këtë Ministrin duke deklaruar masat të cilat ai i ka ndërmarrë që janë referuar në paragrafin 2. të këtij neni.

Neni 342
Mbrojtja e të drejtave të debitorit

1. Gjatë përmbarimit të kërkesave, Përmbaruesi Privat i përmbahet këtij ligji, vendimeve gjyqësore dhe kërkesave te parashikuara në Aktvendimin për përmbarim duke u kufizuar në përmbarimin e veçantë të instrumenteve dhe objekteve të caktuara.

2. Gjate zbatimit të përmbarimit duhet pasur kujdes për mbrojtjen e dinjitetit te personalitetit të debitorëve, dhe përmbarimi duhet të jetë sa më i përballueshëm për debitorin.

3. Menjëherë pas përfundimit të veprimeve të përmbarimit apo aktivitetit që ka të bëjë me sigurimin e kërkesës, Përmbaruesi Privat evidenton aktivitetet e përmbarimit që i referohen nenit 349 të këtij ligji.

Neni 354
Zëvendësuesi i përmbaruesit privat

1. Zëvendësuesi i përmbaruesit privat (më tutje: zëvendësuesi) zëvendëson përmbaruesin privat kur ai pengohet në kryerjen e veprimeve përmbarimore për shkak të sëmundjes, mungesës apo revokimit të përkohshëm të drejtës për ushtrimin e profesionit.

2. Personat si në vijim mund të emërohen si zëvendësues të përmbaruesit privat:

2.1. Përmbaruesi Privat;

2.2. personi i cili plotëson kushtet për emërimin si përmbarues privat siç përmendet në nenin 326 të këtij ligji, me përjashtim të kërkesave sipas paragrafit 1. të këtij neni.

3. Ministri me vendim emëron zëvendësuesin e përmbaruesit privat. Vendimi i ministrit për emërimin e zëvendësuesit të përmbaruesit privat është përfundimtar. Personi nga paragrafi. 2., i cili emërohet si zëvendësues i përmbaruesit privat për herë të parë jep betimin para ministrit.

4. Mandati i zëvendësuesit përfundon:

4.1. pas kthimit të përmbaruesit privat për të cilin ka qenë zëvendësues;

4.2. pas skadimit të mandatit për të cilin është zgjedhur si zëvendësues;

4.3. pas shkarkimit nga ministri.

Neni 359
Kontrolli ndaj punës së përmbaruesve privat

1. Mbikëqyrjen ndaj ligjshmërisë së punës së përmbaruesit privat dhe të Odës e kryen Ministria nëpërmjet të personave të autorizuar (inspektorëve) të Ministrisë, sipas detyrës zyrtare apo me propozimin e Kryetarit të Gjykatës kompetente për territorin e së cilës është emëruar Përmbaruesi Privat, Kryetarit të Odës, si dhe me iniciativën e palëve dhe të pjesëmarrësve në procedurë.

2. Ministria është e autorizuar të:

2.1. bëjë shikimin në librat afarist, evidencën, shkresat dhe të sendeve të magazinuara;

2.2. kërkoj nga përmbaruesi publik të gjitha të dhënat e nevojshme për afarizmin e tij;

2.3. marrin nga organet kompetente dhe organizatat të dhëna për afarizmin e përmbaruesve privat;

2.4. iniciojnë procedurën disiplinore kundër përmbaruesit publik apo zëvendësuesit të përmbaruesit publik.

3. Në kuadër të kryerjes së mbikëqyrjes së ligjshmërisë së punës të përmbaruesit privat dhe Odës, personi i autorizuar zyrtari i Ministrisë, mund të urdhëroj masa për mënjanimin e të metave në punën e përmbaruesit privat, dhe të caktoj afatin për të vepruar sipas atyre masave.

Neni 363
Mbikëqyrja e punës së përmbaruesve privat nga Oda

1. Mbikëqyrja ndaj punës së përmbaruesit privat dhe zëvendës përmbaruesit privat do të kryhet edhe nga Oda.

2. Oda kryen mbikëqyrjen sipas detyrës zyrtare së paku një herë në vit.

3. Oda mundet të inspektojë objektet, të dhënat dhe materialin tjetër arkivor të përmbaruesit privat, llogarinë bankare, menaxhimin e objekteve të ruajtura dhe paratë e vendosura si sigurim, dëftesat për paratë e mbledhura si shpërblim apo tarifë e përmbaruesit privat sikurse edhe merr masat tjera në pajtim me ligjin dhe aktet tjera ligjore dhe së këndejmi urdhëron përmbaruesin privat në fjalë të largojë parregullsitë dhe të caktojë afatin kohor për respektimin e tyre.

4. Oda është e autorizuar të urdhërojë përmbaruesin privat të eliminojë të gjitha mangësitë në punën e tij/saj në kuadër të afatit të specifikuar kohor dhe shqipton masat tjera disiplinore në pajtim me ligjin dhe dispozitat tjera.

5. Raportin për kontrollin e kryer Oda ia dërgon Ministrisë.

6. Mënyra e kryerjes së kontrollit së punës së përmbaruesve privat në kuptim të këtij neni e përcakton Kuvendi i Odës.

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

KREU III
PËRJASHTIMI I GJYQTARIT NGA GJYKIMI

Neni 67

67.1 Gjyqtari nuk mund ta procedojë çështjen juridike:

a) në qoftë se është vetë palë, përfaqësues ligjor apo me prokurë i palës, apo në qoftë se me palën është bashkëkreditor apo bashkëdebitor ose i obliguar për regresim, apo në qoftë se në të njëjtën çështje është dëgjuar si dëshmitar ose si ekspert;

b) në qoftë se pala ose përfaqësuesi ligjor apo me prokurë i saj është kushëri gjaku në vijën vertikale deri në cilëndo shkallë, kurse në vijën horizontale deri në shkallë të katërt, apo në qoftë se është bashkëshort, apo gjini e krushqisë deri në shkallë të dytë, pavarësisht nëse martesa ka pushuar ose jo;

c) në qoftë se është kujdestar, adoptues ose i adoptuar i palës, i përfaqësuesit të saj ligjor ose me prokurë;

d) në qoftë se në të njëjtën çështje ka marrë pjese në dhënien e vendimit të gjykatës më të ulët, ose të organit tjetër, ose në procedurën e ndërmjetësimit;

e) në qofte se ka vepruar në çështjen në të cilën është bërë ujdia gjyqësore, e me padinë e ngritur kërkohet anulimi i ujdisë së këtillë;

f) në qoftë se është aksionar apo anëtar i shoqërisë tregtare që është palë në procedurën e iniciuar me padi;

g) në qoftë se ekzistojnë rrethana të tjera që e vejnë në dyshim paanësinë e tij.

Neni 71

71.1 Gjykatësi posa ta kuptojë së është shtruar kërkesa për përjashtimin e tij ose ekzistojnë shkaqet për përjashtimin e tij sipas nenit 67 të këtij ligji, është i detyruar ta ndërpresë procedimin dhe ta njoftojë kryetarin e gjykatës.

Pranueshmëria e kërkesës

73. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

74. Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

75. Gjykata po ashtu u referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashikojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

76. Në vlerësimin e përmbushjes së kritereve të pranueshmërisë siç janë cekur më lart, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqes ankesë kushtetuese, duke iu referuar shkeljeve të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që konteston akt të autoritetit publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës Supreme [CML.nr.45/2018] të 20 dhjetorit 2018.

77. Gjykata thekson se pas pranimit të dokumenteve shtesë nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës, po ashtu në formë të nënkuptuar kontestohen edhe: (i) Konkluzioni e Gjykatës Themelore në Gjakovë [E.nr.2302/9] të 22 majit 2018, dhe (ii) Konkluzioni i Përmbaruesit Privat Gjokë Radi [P.nr.611/18] të 10 tetorit 2018.

78. Në këtë aspekt, Gjykata vlerëson nëse lidhur me vendimet e lartcekura janë përmbushur kriteret e përcaktuara me nenin 49 [Afatet] të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... ."

Rregullin 39 i Rregullores së punës
[Kriteret e pranueshmërisë]

(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit."

79. Ne këtë aspekt Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta janë nxjerrë në shkelje të nenit 31 dhe 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse: (i) Gjykata Supreme nuk kishte respektuar qëndrimin e saj parimor që përcakton se Prokurori i Shtetit mund të paraqes kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë edhe pas afatit ligjor 3 mujor; (ii) vlera reale e borxhit është rritur për shkak të llogaritjes së penaliteteve; (iii) "dokumenti i besueshëm" mbi të cilin bazohet shitja e pronës së tij është i kundërligjshëm sepse nuk është vërtetuar nga gjykatat dhe as nuk është noterizuar; dhe, se (iv) Përmbaruesi Privat Gjokë Radi është në konflikt interesi sepse të njëjtën çështje e ka gjykuar si gjyqtar.

(i) Procedurat e zhvilluara në gjykatat e rregullta lidhur me aspektin material të kërkesës nr. KI23/19, që kanë të bëjnë me pretendimet lidhur me kontratën për hipotekë, llogaritjen e

penaliteteve, vlerën reale të borxhit dhe dokumentit të besueshëm

80. Lidhur me pretendimet e lartcekura, Gjykata thekson se pretendimet lidhur me kontratën për hipotekë, llogaritjen e penaliteteve, vlerën reale të borxhit dhe dokumentit të besueshëm ndërlidhen me procedurën që ka të bëjë me prapësimin e iniciuar nga parashtruesi i kërkesës ndaj Aktvendimit [Ekz.nr.2302/09], të Gjykatës Komunale të 14 dhjetorit 2009, me të cilin ishte lejuar përmbarimi në bazë të dokumentit të besueshëm, ndaj së cilës parashtruesi kishte paraqitur prapësim, i cili ishte refuzuar nga Gjykata Themelore përmes Aktvendimin të Gjykatës Themelore [E.nr.2302/09] të 25 nëntorit 2013. Ndërsa Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.3166/2015] të 31 marsit 2017 e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore [E.nr.2302/09] të 25 nëntorit 2013. Gjykata e Apelit kishte vlerësuar: (i) se Aktvendimi i goditur është i drejtë dhe i ligjshëm sepse nuk karakterizohet me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) se marrëveshja mbi hipotekën e lidhur ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe kreditorit RBKO është dokument përmbarues i parashikuar me ligjin për procedurën përmbarimore; dhe se, (iii) parashtruesi i kërkesës nuk ka argumentuar se dokumenti përmbarues është pa efekt juridik.

81. Andaj, Gjykata vëren se pretendimet lartcekura të parashtruesit të kërkesës ndërlidhet me këtë procedurë e cila kishte kulmuar në Aktvendimin [Ac.nr.3166/2015] e Gjykatës së Apelit, të 31 mars 2017. Andaj, duke pasur parasysh që Gjykata e Apelit ka nxjerrë Aktvendimin [Ac.nr.3166/2015] më 31 marsit 2017, derisa parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 4 shkurt 2019, edhe pse parashtruesi i kërkesës nuk ka cekur specifikisht datën kur e ka pranuar Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, nga faktet e rastit rezulton se nga dita kur ai është njohur me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, kanë kaluar më tepër se 4 (katër) muaj.

82. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej katër (4) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Sabri Gunes kundër Turqisë*, kërkesa nr. 27396/06, Aktgjykim i 29 qershorit 2012, paragrafi 39; shih gjithashtu, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI140/13, me parashtrues *Ramadan Cakiqi*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 17 marsit 2014, paragrafi 24; dhe KI120/17, me parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 39).

83. Andaj, nga arsyet e shtjelluara si më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit lidhur me pretendimet që ndërlidhen me Aktvendimin [Ac.nr.3166/2015] të Gjykatës së Apelit, të 31 mars 2017, nuk është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.

(ii) Procedurat e zhvilluara për përjashtimin e Përmbaruesit Privat Gjokë Radi

84. Në vazhdim, Gjykata vlerëson nëse lidhur me këtë pjesë të kërkesës parashtruesi ka përmbushur kriteret e nenit 49 të Ligjit, në lidhje me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës, ku Gjykata duhet të shqyrtojë nëse është përmbushur kriteri për afatin 4 (katër) mujor, në raport me "vendimin e fundit" të nxjerrë si rezultat i "mjetit juridik efektiv," siç kërkohet me kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Ligj dhe të qartësuar më tej me Rregullore.

85. Gjykata vlerëson se kërkesa për shterjen e mjeteve juridike dhe kriterin që kërkesa të paraqitet brenda afatit prej 4 (katër) muajve janë të ndërlidhura ngushtësisht (shih, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Jeronovičs v. Latvia,* Aktgjykim i 6 qershorit 2016, paragrafi 75).

86. Gjykata në vazhdimësi ka theksuar se parashtruesit e kërkesave duhet t'i shterojnë të gjitha mjetet juridike të cilat pritet të jenë, ndër të tjera, efektive. Vetëm mjetet efektive mund të merren parasysh nga Gjykata, pasi parashtruesit e kërkesave nuk mund te zgjasin afatet kohore të parapara me Ligj dhe Rregullore te punës, duke përdorur mjete juridike të cilat nuk parashihen (nuk lejohen) me ligj (shih, *mutatis mutandis,* rastin e GJEDNJ-se, *Fernie kundër Mbretërisë* së *Bashkuar,* nr. 14881/04, Vendim i janarit 2006; shih gjithashtu Gjykata Kushtetuese, rasti KI120/17, me parashtrues *Hafiz Rizahu,* Aktvendimi për Papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 31, rasti KI118/17 me parashtrues *Isuf Bajrami,* Aktvendimi për Papranueshmëri, i 19 prillit 2018, paragrafi 37, dhe së fundmi rasti KI141/18 me parashtrues *Gordana Doncic,* Aktvendimi për Papranueshmëri, i 26 shtatorit 2018, paragrafi 42).

87. Në këtë aspekt Gjykata thekson se vlerësimi nëse një mjet juridik është efektiv nga pikëpamja Ligjit dhe Rregullores së punës, dhe të cilat parashtruesit janë të obliguar të shterin dhe të cilat duhet të merren parasysh për qëllim të afatit katër (4) mujor, varet nga një numër faktorësh, saktësisht nga ankesa e parashtruesit, fushëveprimi i obligimeve ligjore the kushtetuese të gjykatave të rregullta dhe specifikave të rastit.

88. Gjykata rikujton se pas kërkesës së kreditorit RBKO, Gjykata Themelore në Gjakovë me Konkluzionin [E.nr.2302/9] të 22 majit 2018, lejoi transferimin e lëndës përmbarimore te Përmbaruesi Privat Gjokë Radi.

89. Gjykata përsërit se Gjykata Themelore në Gjakovë me Konkluzion [E.nr.2302/9] të 22 majit 2018, kishte përcaktuar se ndaj Konkluzionit në fjalë nuk lejohet ankesa-çka lë të kuptohet-se i vetmi mjet juridik në dispozicion të parashtruesit të kërkesës është kërkesa kushtetuese.

90. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pas pranimit të Konkluzionit të Gjykatës Themelore në Gjakovë [E.nr.2302/9] të 22 majit 2018, i ishte drejtuar Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit me propozim që të paraqet kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, duke pretenduar se përmbaruesi privat kishte konflikt interesi ne rastin konkret.

91. Gjykata po ashtu vëren se Prokurori i Shtetit-bazuar në kërkesën e parashtruesit të kërkesës-kishte paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme.

92. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet Aktvendimit të Gjykatës Supreme [CML.nr.45/2018] të 20 dhjetorit 2018, që përcakton (i) se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me Aktvendim me të cilin lejohet përmbarimi apo Aktvendim me të cilin është vendosur për prapësim, por në pyetje janë Konkluzione kundër të cilëve nuk lejohen kurrfarë mjete të goditjes pasi që me to zbatohen disa veprime dhe drejtohet procedura përmbarimore siç parashihet me nenin 3 pika 5 të ligjit për procedurë përmbarimore; (ii) se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë bazuar në nenin 247 të LPK-së mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së kompetencës territoriale, nëse gjykata e shkallës së parë ka nxjerrë vendim pa seancë kryesore, apo në rast se në kundërshtim me ligjin është përjashtuar publiku pa seancë kryesore, gjë që ky nuk ishte rasti lidhur me kërkesën e parashtruesit. Gjykata Supreme po ashtu gjeti se (iii) kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë sa i përket Konkluzionit të Gjykatës Themelore është edhe e paafatshme sepse është paraqitur pas afatit 3 mujor të paraparë me dispozitën e nenit 245.1 të ligjit të procedurës kontestimore.

93. Andaj, Gjykata vlerëson se "vendimi i fundit" lidhur me pretendimin për rolin e dyfishtë të Gjokë Radit si gjyqtar dhe organ përmbarues në të njëjtën çështje përmbarimore është Konkluzioni i Gjykatës Themelore në Gjakovë [E.nr.2302/9] i 22 majit 2018, pasi lidhur me këtë çështje vetë parashtruesi i kërkesës nuk kishte ndonjë mjet në dispozicion për ankesë qoftë në Gjykatën e Apelit ose në Gjykatën Supreme. Ndërsa, kërkesa për mbrojte të ligjshmërisë e paraqitur nga Kryeprokurori i Shtetit nuk plotësonte kushtet ligjore për t'u trajtuar nga Gjykata Supreme, edhe sikur një kërkesë e tillë të paraqitej brenda afatit të paraparë, ashtu si pretendon parashtruesi i kërkesës.

94. Gjykata sërish thekson se pas pranimit të Konkluzionit të Gjykatës Themelore në Gjakovë [E.nr.2302/9] të 22 majit 2018, parashtruesi i kërkesës nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore ose procedurale që të dorëzon kërkesë kushtetuese në këtë Gjykatë (shih rastin e Gjykatës KI112/19 *Parashtrues Ilir Kabashi*, cituar më lart, paragrafi 42).

95. Gjykata vëren se Gjykata Themelore në Gjakovë ka nxjerrë Konkluzionin [E.nr.2302/9] më 22 maj 2018, derisa parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 4 shkurt 2019.

96. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për rolin e dyfishtë të Gjokë Radit si gjyqtar dhe organ përmbarues po ashtu duhet të refuzohen si të paafatshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.

97. Gjykata po ashtu vëren se Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë me [PPP.nr.74/19] e 12 marsit 2019, me të cilin u refuzua si e pabazuar kërkesa debitorit-parashtruesit të kërkesës për përjashtimin e Përmbaruesit Privat Gjokë Radi, nuk është kontestuar nga parashtruesi i kërkesës shprehimisht, por as në formë të nënkuptuar, sepse aktvendimi në fjalë është vënë në dispozicion të Gjykatës pas pranimit të dosjes së plotë të lëndës.

98. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë me [PPP.nr.74/19] e 12 marsit 2019, po ashtu nuk mund të jetë objekt shqyrtimi kushtetues për shkaqet e dhëna në paragrafin e mësipërm.

Kërkesa për masë të përkohshme

99. Gjykata po ashtu vëren se parashtruesi i kërkesës ka kërkuar caktimin e masës së përkohshme *"me qëllim të mbrojtjes së paluajtshmërisë së tij dhe shmangies së dëmit të pariparueshëm."*

100. Gjykata i referohet nenit 27 [Masat e përkohshme] të Ligjit, që parasheh:

> *"1.Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.*
>
> *2.Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale".*

101. Gjykata vëren se në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës ka kërkuar caktimin e masës së përkohshme pothuajse një (1) vit pas dorëzimit të kërkesës, dhe për më tepër, Gjykata ka shpallur kërkesën të papranueshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.

102. Gjykata refuzon kërkesën për caktimin e masës së përkohshme.

Përfundim

103. Gjykata vlerëson (i) se pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me aspektin material të kërkesës KI23/19 dhe pretendimet për rolin e dyfishtë të Gjokë Radit si gjyqtar dhe organ përmbarues në të njëjtën çështje përmbarimore duhet të refuzohen si të paafatshme; (ii) Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë me [PPP.nr.74/19] i 12 marsit 2019, nuk mund të jetë objekt i shqyrtimit kushtetues për shkak se i njëjti nuk është kontestuar nga parashtruesi i kërkesës shprehimisht, por as në formë të nënkuptuar; dhe (iii) kërkesa për masë të përkohshme e paraqitur një (1) vit pas dorëzimit të kërkesës, po ashtu refuzohet pasi që kërkesa në tërësi është shpallur e papranueshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës, nenet 47 dhe 49 të Ligjit dhe rregullat 39 (1) (c) dhe 59 (1) të Rregullores së punës, më 7 tetor 2021, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. TA REFUZOJË kërkesën për caktim të masës së përkohshme;

III. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;

IV. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë

Gjyqtarja raportuese

Remzije Istrefi-Peci

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

REPUBLIKA E KOSOVËS · GJYKATA KUSHTETUESE · REPUBLIC OF KOSOVO · CONSTITUTIONAL COURT · РЕПУБЛИКА КОСОВО · УСТАВНИ СУД

Gresa Caka-Nimani